



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

*Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738*

*E-mail: [rmuca@klsb.org.al](mailto:rmuca@klsb.org.al); Web-site: [www.klsb.org.al](http://www.klsb.org.al)*

**Auditim performance:**

**“IMPLEMENTIMI I POLITIKAVE QEVERTARE  
PËR MBROJTJEN E MJEDISIT”**

**Përmbledhje Ekzekutive**

Në zbatim të planit vjetor 2015, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI etj.), sipas shkresës nr. 861, datë 08.09.2014, njoftim për fillim auditimi, ndërmori auditimin me temë “Implementimi i politikave qeveritare për mbrojtjen e mjedisit”.

Ky auditim u programua për t’u ushtruar në Ministrinë e Mjedisit(MM) dhe në institucionet e saj të varësisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit(AKM) dhe Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave(ISHMPU) si institucionet përgjegjëse për politikën, monitorimin dhe kontrollin e mjedisit në Shqipëri

Pas përfundimit të punës paraprake audituese më datë 08.01.2015 u përgatit programi auditues. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën nr 861/2, datë 05.05.2015 iu dërgua projekt-raporti i auditimit subjekteve të audituara. Raporti përfundimtar është hartuar pasi janë shqyrtuar shpjegimet e dërguara nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit me shkresën nr. 861/3 prot., datë 01.06.2015.

Në përfundim, pasi Kryetari u njoh me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, shkronja “c” të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”:

**K O N K L U D O I:**

**Për Ministrinë e Mjedisit; Agjencinë Kombëtare të Mjedisit si dhe Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave :**

Megjithëse nga ana strukturore mjedisi në Shqipëri ka institucione të mirë-organizuara, problemet mjedisore nuk janë fenomene që mund të merren lehtë ose edhe më keq, të mos vihen re. Ndërsa kemi me dhjetëra hotspot-e të dokumentuara dhe të pa dokumentuara, të

trashëguara nga sistemi komunist, kemi me dhjetëra hotspot-e apo probleme të tjera mjedisore të krijuara nga industritë ndotëse këto njëzet vitet e fundit. Megjithëse janë vërë re disa përmirësime në landfill-et dhe trajtimin e ujërave të ndotura, progresi ka qenë përgjithësisht minimal dhe në disa vende është vërejtur regres, duke shfaqur një trend të rrezikshëm për mjedisin dhe arritjen e kritereve mjedisore të BE-së. Shkatërrimi i parqeve natyrore, ndotja e ujërave të lumenjve dhe deteve, ndotja e tokës, zhdukja e pyjeve dhe zhdukja e shpejtë e biodiversitetit dhe ekosistemeve mund të jetë e pakthyeshme, nëse vazhdohet me ritmin aktual dhe mund të rezultojnë në një rrezik serioz për jetën e popullsisë në terma afatgjatë, si dhe një pengesë në integrimin e suksesshëm të Shqipërisë në strukturat evropiane.

Politikat mjedisore të BE-së, me të cilat institucionet shqiptare po kërkojnë të afrohen gjithnjë e më shumë, synojnë të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit për gjeneratat aktuale dhe të ardhshme, duke u përpjekur që të parandalojnë më tepër se sa të luftojnë zbutjen e kushtueshme të rezultateve të ndotjes dhe degradimit të mjedisit. Këto politika janë të bazuara në integrimin e mbrojtjes së mjedisit dhe në parimin që ndotësi paguan, duke luftuar dëmin mjedisor në burim dhe duke ndarë përgjegjësitë. Garantimi i zbatimit të politikave mjedisore kërkon investime të konsiderueshme, por edhe sjell përfitime jetësore. Thjesht përafrimi i bazës ligjore të BE-së nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur kriteret mjedisore për integrimin e Shqipërisë në BE. Një administratë kompetente dhe e pajisur mirë duhet të jetë funksionale nëse duam që të zbatojmë me sukses këto ligje.

Ajri, cilësia e tij në përgjithësi dhe e atij urban në veçanti është një prej problemeve mjedisore të Shqipërisë. Tashmë ka prova bindëse se ndotja e ajrit në qytetet evropiane është përgjegjëse për një numër të konsiderueshëm të vdekjeve, të shtrimeve në spital dhe rëndim të simptomave, veçanërisht në lidhje me sëmundjet kardio – respiratore dhe për këtë shkak, vendi ynë nuk mund të përbëjë përjashtim nga kjo situatë. Nisur nga kjo, por edhe nga vetë situata në të cilën ndodhen qendrat urbane në vendin tonë, ajri, cilësia dhe parametrat aktualë janë konsideruar problemi social i këtij auditimi.

Monitorimi i ajrit nuk është në linjë me kërkesat e BE-së. Stacionet e monitorimit japin të dhëna të përqendrimeve të cilësisë së ajrit, por Siguria dhe Kontrolli i Cilësisë së këtyre të dhënave janë të papranueshme. Për të zhvilluar një sistem informacioni dhe monitorimi të mirëpajisur dhe të konsoliduar është e nevojshme të merren sa më shpejt masat e duhura.

Inspektimi mjedisor është pjesërisht në linjë me “*acquis communautaire*”. Vërehet mungesë e kapaciteteve profesionale. Nuk ekzistojnë strategjitë për trajnimin e stafit të Ministrisë së Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave.

Ka mungesa në buxhetet e institucioneve për të siguruar mjetet e duhura për zbatimin e të gjithë ciklit të inspektimit mjedisor. Përpjekje të veçanta janë të nevojshme në planifikimin e inspektimit, në bashkëpunimin efektiv ndërmjet inspektorëve të mjedisit dhe autoriteteve të tjera mbikqyrëse, si dhe në përmirësimin e sistemit për raportimin dhe vlerësimin e punës së inspektoratit.

Kërkohet një sistem më efektiv për ndjekjen penale të shkelësve të legjislacionit mjedisor, si dhe një sistem efektiv të detyrimit të zbatimit të ligjit.

Nuk ka plane lokale për sa i përket cilësisë së ajrit në mjedis dhe asnjë aktivitet nuk ka filluar për të përmirësuar tejkalimin e vlerave limite të njohura tashmë.

Duke analizuar politikat qeveritare për mbrojtjen e mjedisit, grupi i auditimit të KLSH-së është përpjekur t'i japë përgjigje pyetjes: A është e pranueshme cilësia e ajrit në qarqet Tiranë, Durrës dhe Elbasan? Shtjellimi i pyetjeve dhe nënpyetjeve të tjera, ka bërë që të arrihet në këtë Mesazh auditimi:

“Ministria e Mjedisit megjithëse ka hartuar kuadrin legjislativ të përafuar me kërkesat e fushës të BE-së, nuk ka realizuar plotësisht aktet nënligjore përkatëse, kryesisht lidhur me Direktivat mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Krimit Mjedisor. Veç sa më sipër, mungesa e zbatimit të legjislacionit mjedisor vazhdon të mbetet problem me ndikime të konsiderueshme negative në cilësinë e ajrit, për shkak të klimës së mos ndëshkueshmërisë së krimit mjedisor.

Performanca e institucioneve dhe punonjës përgjegjës për monitorimin dhe kontrollin e cilësisë së ajrit është e ulët për shkak edhe të mungesës së fondeve, mospërputhjes së kërkesave të vendit të punës me përgatitjen profesionale të tyre dhe për pasojë nivelin e ulët të ndëgjegjës juridike për të dhënë zgjidhje ligjore problemeve mjedisore.

Si rezultat, taksapaguesit dhe opinioni publik edhe pse gëzojnë të drejtën kushtetuese për t'u informuar mbi gjendjen e mjedisit në të cilin jetojnë, informohet dhe konsultohet në mënyrë jo të plotë për këto çështje”.

Nisur nga konkluzionet mësipërme dhe rezultatet e punës audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të këtij sektori Kryetari i KLSH-së:

## **V E N D O S I:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të Performancës “Implementimi i politikave qeveritare për mbrojtjen e mjedisit”, të ushtruar në Ministrinë e Mjedisit dhe në institucionet e saj të varësisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave.

**II.** Të miratojë rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

### ***I. Për Ministrinë e Mjedisit:***

1. Të rishohë detyrimet që rrjedhin nga Konventat dhe Protokollet në fushën e mjedisit në të cilat Shqipëria është vend anëtar, me qëllim krijimin e një kuadri të qartë të këtyre detyrimeve. Mbi këtë bazë, të reflektohet në aktivitetet vjetore të institucioneve të përfshira, si dhe të merren masa për realizimin e raportimeve vjetore dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore.

***Deri më 30.10.2015***

2. Të përshtasë Direktivën 94/63/EC të ndryshuar me Rregulloren (EC) Nr 1882/2003 dhe të përgatisë udhëzimet e nevojshme për zbatimin e saj.

***Deri më 31.12.2015***

3. Të bëjë standardizimin e parametrave të matjes së elementëve ndotës të ajrit, bazuar në Direktivën 2008/50/EC, me qëllim evidentimin real të situatës dhe marrjen e masave për përmirësimin e këyre treguesve.

*Menjëherë*

4. Të përafrojë legjislacionin horizontal mjedisor dhe në mënyrë të veçantë Direktivat për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, kryesisht përgatitjen e bazës së nevojshme ligjore për parandalimin dhe ndëshkimin e krimit mjedisor në funksion të zbatimit të një sistemi më efektiv të përmirësimit të situatës mjedisore.

*Në vazhdimësi*

5. Të hartojë dhe miratojë aktet nënligjore që rrjedhin në zbatim të ligjit nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, duke sjellë pasojë juridike në përmirësimin e situatës mjedisore.

***Ne nenin 29 te ligjit parashikohen dy afate per aktet n/ligjore, 6 muaj dhe 3 vjet****Në vazhdimësi*

6. Të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga Strategjitë për mbrojtjen e mjedisit, duke analizuar treguesit përkatës, situatatën dhe masat që duhen marrë për të ardhmen.

*Në vazhdimësi*

7. Të hartojë dhe miratojë Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e saj, duke evdientuar detyrat, të drejta dhe përgjegjësitë e secilës Drejtori dhe nëpunës të saj.

*Deri më 30.09.2015*

8. Të marrë masa që ndryshimet e strukturave organizative në institucionet e varësisë, të shoqërohen me përmirësimet e nevojshme në hartimin dhe miratimin, e Rregulloreve të brendshme të organizimit dhe të funksionimit të institucioneve përkatëse, në funksion të rritjes së performancës së burimeve njerëzore.

*Në vazhdimësi*

9. Të marrë masat e nevojshme për rritjen informimit dhe të pjesëmarrjes së publikut të gjerë gjatë dëgjësive. Sygjerohet që përveç formave elektronike të njoftimit për dëgjësat me publikun të përdoren edhe ato konvencionale. Gjithashtu sygjerohet përdorimin e ambienteve të hapura për të rritur ndërgjegjësimin mjedisor.

*Në vazhdimësi*

10. Të sigurojnë informacionin mbi shkallën e ndotjes së mjedisit nga shkarkimet në ajër të automjeteve, nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, gjatë kontrollit teknik nga kompania koncesionare SGS, sipas detyrimit që ka kjo e fundit për të raportuar në AKM.

*Deri më 30.09.2015*

11. Të arrijë në zgjidhjen e duhur lidhur me kalimin dhe përdorimin nga ana e AKM të fondeve dhe burimeve njerëzore të nevojshme, sipas detyrimeve përkatëse ligjore për çështjet mjedisore.

*Në vazhdimësi*

12. Të rrisë numrin e punonjësve të Drejtorisë së Mjedisit në MM, kryesisht për Sektorin e ajrit, kimikateve dhe ndryshimeve klimatike, si dhe të hartojë planin vjetor të trajnimeve të kësaj drejtorie.

*Në vazhdimësi*

13. Të hartojë, miratojë dhe zbatojë kritere specifike për rekrutimin e punonjësve të bazuar në kërkesat sipas pozicioneve të punës, duke rritur performancën e tyre dhe besueshmërinë në publik e më gjerë të rezultateve në treguesit mjedisor. Njëkohësisht të hartojë një program masash mbi ecurinë që duhet të ndiqet për zëvendësimin e personelit të papërshtatshëm me pozicionin e vendit të punës që kryen.

*Në vazhdimësi*

14. Të hartojë dhe zbatojë një Strategji të veçantë për trajnimin e punonjësve brenda institucionit, nga entet e tjera shtetërore si dhe nga projektet e huaja me qëllim rritjen e efikasitetit të tyre në realizimin e detyrave në funksionin përkatës.

*Brenda vitit 2015*

## **II. Për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM):**

15. Të sigurojë informacionin mbi shkallën e ndotjes së mjedisit nga shkarkimet në ajër të automjeteve, nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, gjatë kontrollit teknik nga kompania koncesionare SGS, sipas detyrimit që ka kjo e fundit për të raportuar në AKM.

*Deri më 30.09.2015*

16. Të realizojë matjen e të gjithë indikatorëve të cilësisë së ajrit si dhe të bëjë Sigurinë dhe Kontrollin e Cilësisë së këtyre të dhënave. Të bëjë kalibrimin e pajisjeve që bëjnë matjen e indikatorëve të cilësisë së ajrit. Të përgatisë një rregullore për mirëmbajtjen teknike sipas pasaportës së çdo pajisjeje dhe në përfundim të bëjë akreditimin e menjëhershëm të Laboratorit që mat cilësinë e ajrit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

*Brenda vitit 2015*

17. Të hartojë, miratojë dhe zbatojë kritere specifike për rekrutimin e punonjësve të bazuar në kërkesat sipas pozicioneve të punës, duke rritur performancën e tyre dhe besueshmërinë në publik e më gjerë të rezultateve në treguesit mjedisor. Njëkohësisht të hartojnë një program masash mbi ecurinë që duhet të ndiqet për zëvendësimin e personelit të papërshtatshëm me pozicionin e vendit të punës që kryen.

*Në vazhdimësi*

18. Të hartojë dhe zbatojë një Strategji të veçantë për trajnimin e punonjësve brenda institucionit, nga entet e tjera shtetërore si dhe nga projektet e huaja me qëllim rritjen e efikasitetit të tyre në realizimin e detyrave në funksionin përkatës.

*Brenda vitit 2015*

### **III. Për Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave:**

19. Të hartojë, miratojë dhe zbatojë kritere specifike për rekrutimin e punonjësve të bazuar në kërkesat sipas pozicioneve të punës, duke rritur performancën e tyre dhe besueshmërinë në publik e më gjerë të rezultateve në treguesit mjedisor. Njëkohësisht të hartojë një program masash mbi ecurinë që duhet të ndiqet për zëvendësimin e personelit të papërshtatshëm me pozicionin e vendit të punës që kryen.

***Në vazhdimësi***

20. Të hartojë dhe zbatojë një Strategji të veçantë për trajnimin e punonjësve brenda institucionit, nga entet e tjera shtetërore si dhe nga projektet e huaja me qëllim rritjen e efikasitetit të tyre në realizimin e detyrave në funksionin përkatës.

***Brenda vitit 2015***

21. Të rrisë sasinë dhe cilësinë e inspektimeve, duke forcuar masat ndëshkuese deri dhe në kallëzime penale për subjektet që cënojnë kërkesat e ligjit mjedisor, me qëllim frenimin e shkatërrimit mjedisor në vend.

***Në vazhdimësi***

22. Të krijojë dhe publikojë, në faqen e saj të web-it, arkivin e dhënave mbi rezultatet e inspektimeve me specifikime të qarta dhe të plota mbi shkelësin, impaktin që shkakton shkelja dhe se cili nga elementët e mjedisit është dëmtuar. Kjo do të shërbejë jo vetëm për rritjen e transparencës me publikun, por edhe për bërjen publike të shkelësit të ligjit.

***Brenda vitit 2015***

Grupi i auditimit

Artur Hasanbelliu

Mimoza Lloji

Ermira Vojka

Sazan Guri

Melina Kabo

Drejtori

Rinald Muça

Tiranë, Qershor 2015